



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0804

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Aritech”, kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me paisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8, me 13/10/2025, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e OE “Aritech” me nr. 2025/0804, e datës 22/08/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me paisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Komuna e Vushtrrisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me paisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Aritech”.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me paisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8.

Me datën 19.08.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar njoftimin për anulim të kontratës.

Me datën 12.08.2025, OE "Item EL" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. Vendimi lidhur me kërkesën për rishqyrtim është nxjerrë me datën 13.08.2025.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 31.08.2025 operatori "Aritech" SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0804 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 03.09.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së

Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE "Aritech" SH.P.K

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, pasi shqyrtoi kërkesën tuaj për rishqyrtim të datës 12.08.2025, të parashtruar në bazë të Nenit 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP), të ndryshuar dhe plotësuar, konstaton se kërkesa është e palejuar dhe, si rrjedhojë, nuk mund të trajtohet në themel.

II. Arsyeimi procedural-Sipas legjislacionit për prokurimin publik, kërkesa për rishqyrtim në lidhje me vendimin për dhënie të kontratës mund të bëhet vetëm pas publikimit të formularit B-58 – Njoftimi për Dhënie të Kontratës. Në rastin konkret, për aktivitetin e prokurimit është anuluar vetëm formulari B-58 – Njoftimi për Dhënie të Kontratës, e i cili paraqet fazën përfundimtare të dhënies së kontratës dhe nuk hap të drejtën për rishqyrtim sipas Nenit 108A të LPP-së. Për rrjedhojë, kërkesa për rishqyrtim është e palejuar në këtë fazë.

III. Arsytimi ligjor i vendimit për anulim-Vendimi për anulimin e aktivitetit është marrë në përputhje të plotë me: Nenin 26 të LPP-së (“Nënshkrimi i kontratës”) – ndalon nënshkrimin e kontratës nëse, pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, nuk ka mjete financiare të disponueshme për realizimin e saj; Nenin 62 të LPP-së (“Përfundimi i aktivitetit të prokurimit”) – autorizon Autoritetin Kontraktues të përfundojë aktivitetin e prokurimit kur ndryshojnë kushtet objektive, përfshirë gjendjen financiare.

Pas vendimit të OSHP-së dhe kthimit të procedurës, është konstatuar ndryshim i gjendjes financiare për shkak të vendimeve përmbarimore dhe obligimeve të tjera, duke bërë që mjetet e zotuarra më herët të mos jenë më të disponueshme. Ky fakt është vërtetuar zyrtarisht nga Drejtoria e Financave më datë 06.08.2025.

Pretendimet e Ankuesit "Aritech" SH.P.K ne ankesën 0804/2025

Me datë 12.08.2025, kompania Aritech Shpk, përmes platformës së e-prokurimit, ka paraqitur “Kërkesë për rishqyrtim” lidhur me vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi i njëjti kishte kaluar të gjitha fazat dhe anulimi në fund të procesit është arbitrar i padrejtë dhe i pa baze ligjore! Me datë 13.08.2025, AK refuzoi kërkesën tonë, sërish sipas gjykimit tonë në mënyrë arbitrare, duke konstatuar (sipas tyre) se ankesa në këtë fazë është e palejuar. Foto 1- Citim nga vendimi: Nr. 835/25. Trajtimi i kërkesës sonë për rishqyrtim si të PALEJUAR dhe, si e tillë, e patrajtueshme nga AK, kjo tregon sërish arbitraritetin që ky autoritet ka shfaqur në raport me trajtimin e ofertës së Aritech Shpk. Pas hapjes dhe shqyrtimit të ofertave nga OE-të më datë 07.04.2025, ku rezultoi se oferta e Aritech Shpk ishte me çmimin me te ulet, kanë filluar përpjekjet e vazhdueshme nga AK për të gjetur arsye për ta eliminuar ofertën tonë si të papërgjegjshme. Fillimisht, AK ka kërkuar disa herë me radhë informacione shitesë për dokumente të cilat ishin tashmë të ngarkuara në platformën e e-prokurimit dhe të panevojshme për procesin. Ndër të tjera, u kontestua edhe ekzistenca e MAF (autorizimeve nga prodhuesi), dokumente që jo vetëm ishin të ngarkuara, por përbënin edhe parakusht për kualifikim në kontratën bazë me AQP! Po ashtu, në mënyrë arbitrare u cilësua si “çmim jonormalisht i ulët” vlera e një artikulli, ndonëse nuk plotësohej asnjë nga kushtet ligjore për t’u klasifikuar si i tillë. Duam të theksojmë se vlerësimi i çmimit jo-normalisht te ulet behet sipas formulave matematikore të përcaktuara me ligj të cilat autoriteti kontraktues nuk i ka përfillur! Megjithatë argumentet tona të mjaftueshme, AK nuk i mori parasysh. Për më tepër, kërkesa të ngjashme nuk iu drejtuan asnjë OE-je tjetër, duke treguar qartësisht se trajtimi ka qenë selektiv. Eliminimi i Aritech Shpk u bë në mënyrë të pabazuar dhe arbitrare, gjë që u vërtetua edhe nga vendimi i OSHP nr. 2025/0454, i cili konstatoi se pretendimet tona ishin të drejta dhe urdhëroi kthimin e çështjes për rivlerësim. Ky vendim konfirmoi se AK kishte kryer parregullsi në procesin e vlerësimit dhe eliminimit, duke shkelur kërkesat ligjore për një procedurë të drejtë, të barabartë dhe profesionale. Pavarësisht kësaj, është e qartë se zyrtari i prokurimit, z. Ilmi Azemi, ka vepruar në mënyrë arbitrare duke anuluar të gjithë aktivitetin e prokurimit, duke u munduar të gjejë justifikime ligjore por me reference krejt të pasakte. Megjithatë, arsyeja e vërtetë mbetet shmangia e shpërbërimit të kontratës për Aritech Shpk. Foto 2- Citim nga shkresa e datës 19.08.25 ku z.Ilmi Azemi dëshmon qe këtë proces e ka incuar vet ai . Me gjithë atë z.Ilmi Azemi i është referuar pikave të ligjit për anulim kur të njëjtat nuk paraqesin ndonjë bazë ligjore të qëndrueshëm me gjithë se tek refuzimi i kërkesës ju referohet komplet neneve tjera të LPP. Foto 3- Citim nga arsyetimi dhe baza ligjore qe ka dërguar AK. Foto 4- Citim nga vendimi Nr. 835/25 i datës 13.08.25

Ndër të tjera, AK është thirrur tek Neni 26, paragrafi 2, i cili rregullon se kush duhet të nënshkruajë kontratën me AK-të. Ky nen nuk ka të bëjë me kompetencën për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk mund të përdoret si bazë ligjore për një veprim të tillë. Foto 4-Neni 26- pika 1 dhe 2. Dmth zyrtari Ilmi Azemi i referohet ligjit specifikisht gabim që në fakt është shkelje e rënde dhe e përsëritur. Vlerësojmë se OSHP ka baze të inicoj procedure për marrjen e licencës këtij zyrtari pasi është konstatuar që në vendimin e parë shkelja e tij! Veprimet e AK pas vendimit të OSHP-së: Menjëherë pas vendimit të lartpërmendur të OSHP-së dhe në pritje të një vendimi të ri të AK-së (ku fitues pritej të shpallej Aritech Shpk si oferta me çmimin më të ulët të përgjegjshëm), u vunë re veprime të dyshimta nga ana e AK-së. Konkretisht, më 05.06.2025 zyrtari i prokurimit i komunës i dërgoi një email zyrtarit të financave (z. Isuf Jashari) për të pyetur mbi disponueshmërinë e fondeve për këtë projekt, duke u bazuar në një “informatë jozyrtare” lidhur me buxhetin e aktivitetit. Vlen të theksohet se, sipas dokumentacionit buxhetor, mjetet për këtë projekt ishin të zotuar që nga muaji shkurt 2025 në planifikimin e prokurimit, pra nuk kishte sinjale zyrtare për mungesë fondesh në atë kohë. Me datë 08.08.2025 AK nxori vendim për anulimin e të gjithë procedurës së prokurimit, me arsyetimin zyrtar se “Autoriteti Kontraktues nuk ka mjete buxhetore për realizimin e kontratës”. Ky vendim i papritur erdhi në fazën përfundimtare të aktivitetit, kur procedura e vlerësimit ishte praktikisht e përfunduar dhe pritej vetëm shpallja zyrtare e fituesit, pra Aritech Shpk. Vlen të theksohet që AK gjatë periudhës së njëjtë ka shumë aktivitete të hapura (në proces vlerësimi, shqyrtimi, nënshkrimi, ofertimi) vlera e tyre tejkalon shumë mbi 13 milion euro dhe nuk kemi identifikuar asnjë vendim të ngjashëm ku aktiviteti anulohet për mungesë të fondeve, para këtij aktiviteti apo pas këtij aktiviteti!!! Në vijim, paraqesim argumentet tona ligjore kundrejt vendimit të AK-së dhe shkeljet procedurale/substanciale që kemi identifikuar, duke u mbështetur në dispozitat përkatëse të LPP-së (nenet 6, 7, 26, 59 dhe 62), faktet e konstatuara dhe provat e bashkëngjitura. Argumentet Ligjore dhe Shkeljet e Konstatuara. Shkelja e Parimit të Ekonomicitetit dhe Efikasitetit (Neni 6 LPP) Neni 6 i LPP-së sanksionon parimin e ekonomizimit dhe efikasitetit në prokurimin publik, duke obliguar autoritetet kontraktuese që të sigurojnë përdorimin më ekonomik dhe racional të fondeve publike gjatë realizimit të prokurimeve. Në rastin konkret, veprimet e AK-së bien ndesh me këtë parim bazë:

- Anulimi i procedurës pas përfundimit të vlerësimit cenon rëndë ekonomikitetin e prokurimit. AK zhvilloi të gjitha fazat e tenderimit (hartimi i dosjes së tenderit, publikimi, pranimi i ofertave, vlerësimi i tyre nga komisioni) duke angazhuar resurse financiare e njerëzore, për t'i shpallur më pas rezultatet të pavlefshme në momentin final. Kjo do të thotë se të gjitha kostot dhe përpjekjet e bëra u shpenzuan pa asnjë rezultat, një situatë që do të ishte shmangur plotësisht po të veprimeve me kujdes financiar dhe planifikim të duhur.

- Dëmtimi i interesit publik dhe efikasitetit të prokurimit: Duke anuluar tenderin në këtë fazë të vonë, AK ka rrezikuar realizimin e vetë objektivave të prokurimit në fjalë. Projekti “Furnizim me pajisje të TI” ishte planifikuar për të plotësuar nevojat konkrete të komunës; anulimi i tij vonon ose pamundëson plotësimin e këtyre nevojave, çka dëmton interesin publik. Për më tepër, përsëritja e një procedure të re nga e para (nëse AK synon ta ritenderojë këtë lëndë) do të thotë shpenzime të dyfishta dhe humbje kohe, si për autoritetin ashtu edhe për operatorët ekonomik. Kjo situatë cenon efikasitetin në prokurim dhe përdorimin racional të burimeve publike, siç edhe ne kemi theksuar në kërkesën tonë fillestare për rishqyrtim. Në përmbledhje, AK nuk ka arritur t'i përdorë fondet publike në mënyrë ekonomike dhe efektive në këtë aktivitet, duke shkelur nenin 6 të LPP-së. Një anulim i tillë, i ndërmarrë vetëm pasi procedura kaloi pothuajse të gjitha hapat, përbën shembullin tipik të mosrespektimit të parimit të efikasitetit - rezultatet e prokurimit

(pajisjet e TI) nuk u arritën, ndërsa koha dhe paratë e shpenzuara shkuan dëm. Shkelja e Parimit të Trajtimit të Barabartë dhe Transparencës (Neni 7 LPP) Neni 7 i LPP-së përcakton se autoriteti kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë e jo-diskriminuese dhe të veprojë në mënyrë transparente gjatë gjithë procesit. Në rastin tonë, kemi identifikuar elemente serioze që tregojnë mungesë transparence dhe trajtim të pabarabartë/selektiv nga AK:

- “Skenari” i anulimit për të shmangur shpalljen e Aritech Shpk fituese: Rrethanat faktike sugjerojnë se AK ka vepruar me qëllim për të na përjashtuar nga kontrata, duke përdorur anulimin si mjet. Siç përshkruam më lart, vetëm pasi u konsumuan të gjitha mundësitë procedurale për të eliminuar ofertën tonë si ofertë e papërshtatshme (të cilat dështuan pas vendimit të OSHP-së në favorin tonë), AK kreu veprime të jashtëzakonshme për të shpallur mungesë fondesh dhe anuloi tenderin. Kjo ngre dyshime të arsyeshme se anulimi nuk ishte i diktuar nga ndonjë shkak objektiv i pavarur, por ishte një vendim i paramenduar dhe i motivuar për të mos lejuar shpalljen e Aritech Shpk si fituese. Praktikisht, operatori ekonomik me ofertën më të lirë dhe të përgjegjshme (kompania jonë) u privua nga kontrata jo sepse kishte ndonjë mangësi në ofertë, por për shkak të një manovre të AK-së në prapaskenë.

- Mungesa e transparencës në justifikimin e anulimit: AK e bazon anulimin në një “mungesë fondesh” të papritur, e cila nuk ishte e komunikuar apo e parashikueshme për ne si operator ekonomik gjatë procedurës. Gjatë periudhës së vlerësimit dhe madje as pas vendimit të OSHP-së, ne nuk u informuam fare nga AK për ndonjë problem buxhetor. Vetëm pasi AK mori vendimin për anulim, ne kemi kërkuar qasje në dokumente dhe sqarime mbi arsyet. Nga kjo kemi mësuar për komunikimin e brendshëm të datës 05.06.2025 midis zyrtarit të prokurimit dhe atij të financave, si dhe veprimet e datës 06-08 gusht. Këto informata nuk ishin publike apo transparente gjatë procesit, gjë që tregon mungesë të plotë transparence. Një autoritet kontraktues që vepron me paanshmëri dhe ndershmëri do të duhej të njoftonte në kohë për çfarëdo problemi objektiv (p.sh. reduktim të buxhetit), dhe jo të ndërmerre hapa tinëzisht për të krijuar një arsyetim anulimi pa dijeninë e operatorëve.

- Trajtim jo i barabartë / selektiv: Elementi më shqetësues është se “mungesa e fondeve” duket se është aplikuar selektivisht vetëm për këtë tender. Sipas informatave që kemi mbledhur, gjatë së njëjtës periudhë kohore Komuna e Vushtrisë ka vazhduar pa probleme procedurat e prokurimit për projekte të tjera me vlerë totale mbi 13 milionë €, pa deklaruar mungesë fondesh për to. Nuk kemi dijeni që ndonjë aktivitet tjetër prokurimi i kësaj komune të jetë anuluar për arsye të ngjashme. Si është e mundur që vendimet përmbarimore (apo vështirësitë financiare) të preknin pikërisht fondet e projektit tonë dhe asnjë projekt tjetër? Kjo mospërputhje krijon bindjen se arsyetimi financiar është përdorur si pretekst I sajuar, pra AK nuk i trajtoi tenderët/projektet njësoj, por e targetoi projektin tone në mënyrë diskriminuese. Ky është cenim flagrant i parimit të trajtimit të barabartë- situata të ngjashme (obligime financiare komunale) nuk u trajtuan në mënyrë konsistente, por me standard të dyfishtë në dëm tonin. Në përmbledhje, AK ka vepruar në mënyrë jo-transparente dhe diskriminuese, duke mos i trajtuar ofertuesit me barazi dhe duke përdorur standarde të dyfishta. Këto veprime bien ndesh drejtpërdrejt me detyrimet e nenit 7 të LPP-së për trajtim të barabartë dhe transparencë, dhe cenojnë integritetin e gjithë procesit të prokurimit. Parregullsitë në Vlerësim dhe Vendimmarrje (Neni 59 LPP), Neni 59 i LPP-së përcakton rregullat për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, ku ndër të tjera kërkohet që autoriteti kontraktues të themelojë një Komision Vlerësues profesionist, i cili të bëjë vlerësimin e ofertave me përgjegjësi të plotë individuale dhe integritet. Çdo vendimmarrje në lidhje me shpalljen e fituesit duhet të jetë rezultat i një vlerësimi të paanshëm dhe në përputhje me kriteret e tenderit. Në rastin tonë, procesi i vlerësimit nga AK ka pësuar devijime serioze:

- Eliminimi fillestar i padrejtë i ofertës sonë: Siç u cek më herët, kompania jonë paraqiti ofertën më të lirë dhe plotësisht të përgjegjshme për këtë aktivitet. Kjo nënkupton se, sipas kriterëve të dosjes së tenderit dhe ligjit, Aritech Shpk duhej të ishte fituese legjitime. Megjithatë, komisioni vlerësues/zyrtarët përgjegjës në AK vendosën të na skualifikojnë (ose të mos na rekomandojnë për kontratë) pa ndonjë bazë të qëndrueshme ligjore. Ne e kundërshtuam këtë vendim dhe OSHP, përmes vendimit nr. 2025/0454, i dha të drejtë kompanisë sonë, duke konfirmuar se eliminimi ynë ishte i pabazë dhe se AK kishte bërë shkelje gjatë vlerësimit. Ky fakt tregon se AK fillimisht ka dështuar të zbatojë drejtë nenin 59 të LPP-së, pasi vlerësimi nuk u krye në mënyrë të drejtë, transparente dhe profesionale. U desh ndërhyrja e mekanizmit të jashtëm (OSHP) që të korrigjoheshin gabimet apo padrejtësitë e komisionit vlerësues të AK-së.

- Moszbatimi i rekomandimit të OSHP-së për rivlerësim të drejtë: Pas vendimit të OSHP-së, pritej që AK të rikthente procedurën në shinat e ligjshmërisë – domethënë të bënte rivlerësimin e ofertave në përputhje me konstatimet e OSHP-së dhe dispozitat e LPP-së, dhe pastaj të shpallte fituesin real (që në këtë rast do të duhej të ishte Aritech Shpk si oferta me e favorshme ekonomikisht). Në vend që të zbatonte frymën e vendimit të OSHP-së, AK zgjodhi rrugën e anulimit të aktivitetit. Ky veprim mund të interpretohet si përpjekje për t’iu shmangur detyrimit për të shpallur fitues kompaninë tonë, pra mosrespektim indirekt i vendimit të OSHP-së. Edhe pse teknikisht AK u mbështet në një dispozitë tjetër (nenin 62) për anulim, pasojat janë që rekomandimi i OSHP-së për një rivlerësim të ndershëm nuk u implementua kurrë. Kjo vë në pikëpyetje serioze përkushtimin e AK-së ndaj zbatimit të ligjit dhe vendimeve të organeve mbikëqyrëse.

- Dyshime mbi paanshmërinë e komisionit vlerësues/zyrtarëve përgjegjës: Dinamika e ngjarjeve (fillimisht eliminimi pa bazë, pastaj anulimi kur eliminimi u bë i pamundur) ngre dyshimin se komisioni vlerësues ose zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk kanë qenë të paanshëm gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Vendimet e marra sugjerojnë një anim ose qëllim për të favorizuar një ofertues tjetër (ose për të përjashtuar Aritech Shpk) në kundërshtim me kriteret objektive. Kjo përbën shkelje thelbësore të parimit të integritetit në vlerësim, të sanksionuar në nenin 59. Theksojmë se çdo anëtar i komisionit vlerësues mban përgjegjësi individuale për vlerësimin e kryer; nëse provohet që vlerësimi fillestar apo vendimi për anulim është marrë me motive të padrejta, atëherë përgjegjësia bie mbi ata persona konkretë. Sipas kësaj më sipër, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së duke dështuar të kryejë një vlerësim të drejtë, të paanshëm dhe profesional të ofertave. Pasojat e kësaj shkeljeje u manifestuan me nevojën e ndërhyrjes së OSHP-së dhe, në vend se të korrigjohej plotësisht situata, AK e përkeqësoi atë më tej me vendimin e anulimit. Këto veprime çënojnë rëndë besimin në procesin e prokurimit dhe të drejtat e operatorit ekonomik për një trajtim të drejtë. Mos përmbushja e Kushteve për Anulimin e Aktivitetit (Nenet 26 dhe 62 LPP) AK e bazoi juridikisht vendimin e tij për anulimin e prokurimit në nenin 26 dhe nenin 62 të LPP-së. Ne argumentojmë se në rrethanat konkrete, kushtet ligjore për zbatimin e këtyre dispozitave nuk janë përmbushur realisht, dhe se AK i ka keqinterpretuar ose keqpërdorur këto nene për të arsyetuar një vendim arbitrar. Më poshtë shtjellojmë arsyet:

- Neni 26 LPP - Nënshkrimi i kontratës dhe disponueshmëria e mjeteve: Është e vërtetë se, sipas nenit 26, autoriteti kontraktues nuk guxon të nënshkruajë kontratën me operatorin fitues nëse nuk ka mjete financiare të disponueshme për atë kontratë. Ky parim synon të mbrojë buxhetin publik nga obligimet e pambuluara dhe është i padiskutueshëm. Mirëpo, në rastin tonë ky nen nuk duhet të ishte fare pengesë po të ishte menaxhuar korrekt procesi nga AK. Kjo sepse: o Fondi për këtë prokurim ishte planifikuar dhe zotuar paraprakisht në buxhetin e komunës. AK e filloi

procedurën në mars 2025 me bindjen se fondet ekzistojnë. Gjatë gjithë fazave të vlerësimit (prill-maj) nuk u ngrit asnjë shqetësim për mungesë buxheti. Vetëm në qershor-gusht 2025, pasi OSHP na dha të drejtë, u shfaq papritur pretendimi për mungesë fondesh. Kjo ngre pyetjen: çfarë ndryshoi realisht në financat e komunës midis prillit dhe gushtit? Përgjigja e AK-së është "vendimet përmbartimore", por: o Efekti i përmbartimit ishte i pjesshëm dhe i parregullt: Vendimet përmbartimore prekin buxhetin e përgjithshëm të komunës dhe jo një projekt specifik në veçanti. Siç argumentuam në seksionin e mësipërm, nëse përmbartimi do e bënte të pamundur financimin e këtij tenderi, atëherë do duhej të prekte proporcionalisht të gjitha projektet tjera. Por kemi evidence se projektet e tjera vazhduan normalisht. Kjo nënkupton se nuk kemi të bëjmë me një mungesë faktike të fondeve në nivelin e të gjithë komunës, por me një vendim administrativ për të "hequr" fondet pikërisht nga projekti ynë. Kjo është një qasje e kundërt me parimin e trajtimit të barabartë dhe nuk mund të konsiderohet "pamundësi objektive financiare" në kuptimin e nenit 26, por më tepër pamundësi e krijuar apo e zgjedhur nga vetë AK. Edhe nëse supozojmë se më 06.08.2025 AK realisht u vu në dijeni të një situatë financiare problematike, zgjidhja ligjore nuk duhej të ishte menjëherë anulimi i tenderit. Duke qenë se në atë datë vlerësimi i ofertave veçse kishte përfunduar dhe kompania jonë pritej të shpallej fituese, AK mund të kishte trajtuar çështjen me fleksibilitet: p.sh. mund të negocionte me ne shtyrjen e afatit të pagesës apo fazimin e pagesave në mënyrë që kontrata të nënshkruhej pa problem (në faktikisht kemi ofruar gatishmërinë tonë për të pranuar pagesë të vonuar deri në 180 ditë, gjë që do t'i jepte kohë komunës të zgjidhte çështjet buxhetore brenda vitit). AK zgjodhi të mos diskutojë fare një zgjidhje të tillë, por shkoi direkt tek masa ekstreme - anulimi. Kjo tregon mungesë vullneti për zgjidhje dhe nënkupton se synimi ishte eliminimi i kontratës, jo menaxhimi i situatës financiare. Përgjegjësia për planifikimin buxhetor i takon vetë AK-së. Nëse komunës i janë imponuar pagesa përmbartimore në mes të vitit, këto duhet të reflektohen me rialokim buxhetor në nivel të gjithë projekteve, jo duke shënjestruar një prokurim të caktuar. Praktikisht, nëse do të kishte vërtet mungesë të përgjithshme fondesh, komuna do të duhej të shpallte gjendje emergjente financiare dhe të pezullonte disa projekte, duke informuar publikisht për këtë. Në mungesë të një transparence të tillë, arsyetimi i AK-së për mungesë të fondeve nuk qëndron dhe nuk justifikon në mënyrë legjitime anulimin.

- Neni 62 LPP - Përfundimi (anulimi) i aktivitetit për kushte objektive të ndryshuara: Kjo dispozitë i lejon autoritetit kontraktues që, në rrethana të jashtëzakonshme, të përfundojë (anulojë) një aktivitet prokurimi kur ndryshojnë kushtet objektive në mënyrë të tillë që realizimi i kontratës bëhet i panevojshëm ose i pamundur (p.sh. nëse objekti i prokurimit nuk nevojitet më, ose nëse ndodhin zhvillime madhore financiare apo teknike). Ne argumentojmë fuqimisht se në tenderin tonë nuk ka ndodhur një ndryshim i tillë objektiv i rrethanave:

- o Objekti i prokurimit mbetet i nevojshëm dhe i pandryshuar. Anulimi nuk u bë sepse "pajisjet e TI" nuk i duhen më komunës apo se projekti ka humbur qëllimin - përkundrazi, nevojat për pajisje informative në komunë vazhdojnë të ekzistojnë. Pra, qëllimi dhe lënda e prokurimit mbeten të vlefshme, çka do të thotë se anulimi nuk erdhi si pasojë e ndonjë ndryshimi në vetë kërkesën e autoritetit (p.sh. nuk u shua nevoja për furnizim).

- o Situata financiare e pretenduar nga AK nuk përbën "ndryshim objektiv të rrethanave" në kuptimin e ligjit, por më tepër rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të vetë AK-së. Një ndryshim objektiv do të nënkuptonte, bie fjala, nëse Qeveria do t'i shkurtonte buxhetin komunës papritur, ose një fatkeqësi natyrore do të ridestinonte fondet. Këtu kemi një situatë ku komuna vetë vendosi të ndryshojë destinimin e fondeve të zotuar, nën pretekstin e përmbartimeve të cilat çuditërisht prekën vetëm këtë projekt. Kjo nuk është rrethanë që bie jashtë kontrollit të AK-së;

përkundrazi, është një veprim i kontrolluar nga vetë AK. Një “kusht objektiv i ndryshuar” do të ishte i vlefshëm p.sh. në shkallë kombëtare do të vendosej një masë shtrënguese buxhetore për të gjitha komunat - por jo ky skenar selektiv.

o Mospërmbushja e testit të proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë: Edhe në rast se do të pranonim se pati një vështirësi financiare, anulimi i tenderit duhej të ishte masa e fundit, jo opsioni i parë. Neni 62 lejon anulimin, por nuk e imponon atë automatikisht sa herë ka ndonjë vështirësi; duhen pare zgjidhje alternative. Në rastin tonë, siç u përmend, mund të negociohej me OE për shtyrjen e pagesave, ose komunës i lindte detyrimi të provonte se çdo opSION tjetër ishte i pamundur para se të anulonte. AK nuk paraqiti asnjë provë se ka shqyrtuar ndonjë opSION tjetër veç anulimit. Kjo tregon që vendimi nuk ishte i domosdoshëm por i zgjedhur arbitrarisht, gjë që e nxjerr atë jashtë kuadrit të ligjshëm të nenit 62. Si përfundim, AK ka keq zbatuar nenet 26 dhe 62 të LPP-së. Thirrja në to në këtë rast nuk është gjë tjetër veçse justifikim formal për një vendim që në thelb është i pabazë dhe I padrejtë. Nuk pati një ndryshim të vërtetë objektiv që të detyronte anulimin - përkundrazi, “ndryshimi” u krijua nga mënyra selektive si u menaxhuan fondet. Prandaj, vendimi për anulim duhet konsideruar i kundërligjshëm dhe arbitrar, i marrë në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e dispozitave ligjore të sipërcituara.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0804/2025, i cili është dorëzuar me datë 03.09.2025.

Lidhur me pretendimet e OE “Aritech” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0804 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjeje ne pretendimin 1: OE pretendon se AK ka dështuar të vlerësojë drejt ofertën e tyre, përkundër që OSHP me vendimin 2025/0454 kishte konstatuar se eliminimi ishte i padrejtë dhe kishte urdhëruar rivlerësim. Në vend të rivlerësimit, AK e ka anuluar procedurën.

Vlerësimi i Ekspertit: Pretendimi është pjesërisht i bazuar. AK, pas vendimit të OSHP-së, ka konstatuar që oferta e OE Aritech është e përgjegjshme. Megjithatë, për shkak të pamundësisë financiare të krijuar ndërkohë, është vendosur që procedura të anulohet. Vendimi për anulim është kompetencë e AK dhe nuk përbën moszbatim të vendimit të OSHP-së, përderisa vendimi për anulim është mbështetur në dispozita të tjera të LPP-së (Neni 62).

Përgjigjeje ne pretendimin 2: OE pretendon se vendimi për anulim është marrë në mënyrë të pajustificuar, pasi objekti i prokurimit është ende i nevojshëm, ndërsa mungesa e fondeve nuk është pasojë e ndonjë force madhore, por vendim i brendshëm selektiv i AK-së.

Vlerësimi i Ekspertit: Pretendimi nuk qëndron. Neni 62 i LPP-së i mundëson AK-së të përfundojë aktivitetin e prokurimit në rrethana të jashtëzakonshme, siç është pamundësia financiare për realizimin e kontratës. Në këtë rast, bazuar në dokumentacionin e brendshëm, është konstatuar se fondet janë bllokuar për shkak të përbarimeve, gjë që ka pamundësuar

shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës. Kjo përbën bazë të ligjshme për përfundimin e aktivitetit të prokurimit.

Pas shqyrtimit të ankesës së OE “ARITECH” Shpk, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga Autoriteti Kontraktues, ekspertit shqyrtues vlerëson se:

- AK ka vepruar në përputhje me nenin 62 të LPP-së, duke pasur një bazë objektive për anulim – mungesën e fondeve të lira buxhetore.
- Nuk janë identifikuar shkelje të rënda, të cilat do të ndikonin në cënimin e parimeve themelore të LPP-së.
- Vendimi për anulim, ndonëse në fazë të avancuar të procedurës, është një e drejtë ligjore e AK-së në rrethana të jashtëzakonshme të mirë dokumentuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik nuk është pajtuar me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i caktuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, ku kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Aritech” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlerësuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës, 19.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me paisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0801, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.

-Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminoj ose dëmtoj një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRISË**
- **OE - ARITECH**
- Arkivës së OSHP-së: